

## NJOFTIM PËR SHTYP

Në datë 15.06.2023, Kuvendi i Shqipërisë zhvilloi seancën plenare ku Kryetari i Komisionit të Konkurrencës Z. Denar Biba, paraqiti raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022.

Në fjalën e tij Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, z. Biba u ndal në hapat e ndërmarra nga institucioni për sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, por dhe plotësimin e rekomandimeve të lëna në Rezolutën e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së AK për vitin 2021.

Gjithashtu, gjatë fjalës së tij, z. Biba informoi se, gjatë vitit 2022 janë marrë 99 vendime nga Komisioni i Konkurrencës, çka përbën jo vetëm një rekord përgjatë 17 viteve të jetës së AK por tregon dhe punën e vazhdueshme të Autoritetit të Konkurrencës. Po ashtu gjatë këtij viti janë kryer 15 monitorime në tregjet sensitive dhe me ndikim të drejtpërdrejtë për mirëqenien e konsumatorit, si dhe janë realizuar 11 procedura hetimore, përkatësisht: në tregun e tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë; në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare; në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore; në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal; në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike; në tregun ku operojnë subjektet financiare jo banka; në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport; në tregun e ofrimit të shërbimit të instrumenteve matëse nëpërmjet instrumenteve shpërndarëse të karburanteve dhe gazit të lëngshëm; në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos; në tregun e prodhimit të betonit në qarkun Tiranë, Durrës Elbasan; në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllor (ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor).

Pavarësisht se Autoriteti i Konkurrencës ka si parim të aktivitetit të tij, edukimin dhe jo vendosjen e gjobave për subjektet nën hetim, vlen të theksohet se, në përfundim të procedurave hetimore në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të plehrave kimike, në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport, si dhe në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur 4 gjoba për shkelje të rënda të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, në vlerën totale 224,225,947 (dyqind e njëzetë e katër million e dyqind e njëzetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzetë e shtatë) Lekë.

Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës theksoi se ky institucion do të vijojë të përmbushë qëllimin e tij të përcaktuar në ligjin nr. 9121/2003, për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, përmes monitorimeve, hetimeve dhe marrjen e masave të nevojshme në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar, do të vazhdojë përafrimin e legjislacionit në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe do të mbetet i angazhuar në promovimin e advokacisë së konkurrencës me palët e interesit.